



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA-THE MUNICIPALITY
OF SUHAREKË



RREGULLORE
PËR
TAKSA, TARIFA DHE GJOBAT KOMUNALE NË
KOMUNËN E SUHAREKËS

Suharekë 2023

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 2, pika c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008“, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016”, e konform nenit 29, paragrafi 2, pika (c) të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë ne mbledhjen e mbajtur me datën, -----miraton këtë:

RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBAT KOMUNALE NË KOMUNËN E SUHAREKËS

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës dhe tarifës komunale në Komunën e Suharekës, lartësinë e taksave dhe tarifave komunale, përcaktimin e kategorive të liruara nga kjo taksë, tarifë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë dhe tarifën komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdoruar në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **Taksë komunale** – nënkupton shumën fikse dhe e pakthyeshme e pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridik dhe fizik autoriteteve të Komunës në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:

- 1.1.1. lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve tjera zyrtare të lëshuara nga Komuna;
- 1.1.2. shërbimeve administrative të pranuar nga Komuna;
- 1.1.3. ushtrimit të veprimtarisë afariste në territorin e Komunës;
- 1.1.4. pronësisë së mjeteve motorike në territorin e Komunës;
- 1.1.5. ndërtimit, rrënimin të objekteve dhe ndërhyrjeve në infrastrukturë komunale në territorin e Komunës; dhe
- 1.1.6. shfrytëzimit të objekteve, hapësirës apo të mirave tjera publike në territorin e Komunës.

1.2. **Taksa qendrore** – nënkupton taksat që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat mbliidhen nga Komuna;

1.3. **Vit fiskal** - nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetë e një (31) janar të të njëjtit vit:

- 1.4. **Gjobë** – nënkupton sanksionin kundërvajtës që i shqiptohet personave juridik dhe fizik për shkelje të dispozitave të kësaj Rregulloreje,
- 1.5. **Person** – nënkupton personin fizik dhe juridik;
- 1.6. **Person fizik** – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitetin biznesi; dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist;
- 1.7. **Person juridik** – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë;
- 1.8. **Pano reklamuese** – nënkupton tabelën apo shenjën reklamuese me qëllim të reklamimit të mallrave apo shërbimeve, i vendosur në një objekt statik apo lëvizës;
- 1.9. **Shoqëri Tregtare** – nënkupton termin e përgjithshëm që përfshinë çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo ndonjë ligji tjetër, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.
- 1.10. Organi kundërvajtës-nënkupton drejtorinë përkatëse të inspektimeve e cila është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave ndëshkimore të rregullorës.

KAPITULLI II

KORNIZAT E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE KOMUNALE

Neni 4

Parimet e përgjithshme të taksave komunale në Komunë

1. Të gjitha taksat komunale përcaktohen me këtë Rregullore dhe me ndonjë Rregullore tjetër komunale.
2. Të gjitha taksat komunale përcaktohen marrë parasysh parimin e jo diskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Taksat komunale që rezultojnë si pasojë e ndonjë veprimi apo shërbimi të kryer nga organet e Komunës, bazohen në koston e atij veprimi që i është shkaktuar Komunës.
4. Asnjë taksë komunale që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore apo në ndonjë Rregullore tjetër komunale nuk mund të kërkohet që të paguhet.

Neni 5

Pagesa e taksave komunale

1. Të gjitha pagesat e taksave komunale që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe paguhet në valutën euro (€).
2. Të gjitha pagesat mbi dhjetë (10€) sipas kësaj Rregulloreje bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, nëpërmjet një urdhërpagese të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, në xhirollogarinë e Komunës të përcaktuar me vendimin e Kryetarit të Komunës.
3. Të gjitha pagesat deri në dhjetë (10€) sipas kësaj Rregulloreje bëhen pranë institucioneve përkatëse komunale.
4. Për pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni, Komuna lëshon vërtetim përkatës.
5. Të gjitha pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni dhe pagesat e bëra nëpërmjet kioskeve elektronike (e-kiosku), deponohen në xhirollogarinë e Komunës deri në fund të ditës së pranimit.

Neni 6
Lirimet nga taksat komunale

1. Të gjitha kategoritë e liruara nga pagesa e taksave komunale sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, përcaktohen me këtë Rregullore.
2. Për çdo lloj lirim nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, personat që përfitojnë nga ky lirim ofrojnë dokumentacionin përkatës që dëshmon përkatësinë e tyre për të përfituar nga lirimet.
3. Për çdo lloj lirim nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore zyrtari përgjegjës i Komunës ia bashkëngjit lëndës shkresën me bazën ligjore për lirim nga pagesa.
4. Nëse ndonjë procedurëku kërkohet pagesa e taksave komunale është filluar me kërkesëtëmë shumësenjëpersoni, ku jotë gjithë janë të liruara nga pagesa e taksave komunale, atëherë taksa komunale paguhet nga ai personi cilinuk është iliruara nga pagesa, te zyrtari i autorizuar i cili obligohet që palës ti jep dëshmi mbi pagesën e bërë.

KAPITULLI III

Neni 7

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHËSHME

1. Taksat (tarifa) për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare;

SEKTORI I PËRGJITHSHËM	Nr.R	EMËRTIMI (tarifat dhe taksave në shërbime)	Euro
	1.1	Për pranimin e kërkesës	0.50€
1.2	Për fotokopjimin dhe vërtetimin e identitetit nga arkivi.	3.00€	
1.3	Kërkesë për vërtetimin e deklaratës mbi raportin e lidhjes familjare	2.00€	
1.4	Kërkesë për vërtetimin e deklaratës qe personi është i vetëm	2.00€	
1.5	Kërkesë për vërtetimin e deklaratës mbi vendqëndrimin e përkohshëm	2.00€	
1.6	Kërkesë për huazimin e dokumenteve te lejueshme nga arkivi	5.00€	
1.7	Kërkesë për vërtetimin e deklaratës mbi nacionalitetin e qytetarit (kombësin)	2.00€	
1.8	Kërkesë -vërtetimin e deklaratave të ngjashme varësisht nga kushtet aktuale	2.00€	
1.9	Njëjtësimi i dokumentave, një (1) faqe A4 një (1) faqe A3	0.50€	
		1.00€	
1.10	Për vërtetimin qe personi është në jetë (gjallë)	3.00€	
1.11	Kërkesë për referencë	5.00€	
1.12	Për ankesa që paraqiten kundër vendimit të cilin e bien organi i shkallës së parë, paguhet tarifa në shumën prej	5.00€	
	Taksanë Sektorin e gjendjes civile		
GJENDJA CIVILE	1.13	Për ekstrakt të lindjes	1.00€
	1.14	Për certifikatë të martesës	1.00€
	1.15	Për certifikatë të vdekjes	0.00€
	1.16	Për aktvdekje (trashëgimia) Nuk lirohet askush nga kjo tarifë	5.00€
	1.17	Për certifikat të statusit martesor	5.00€
	1.18	Për deklaratë të bashksisë familjare (brenda vendit)	1.00€
	1.19	Për deklaratë të bashksisë familjare (jashtë vendit)	5.00€
	1.20	Për certifikat të vendbanimit	1.00€
	1.21	Për certifikat shtetësie	2.00€
	1.22	Për vërtetim nga arkiva/veretetime/konfirmime/deklarata të ndryeshme	1.00€
	1.23	Për regjistrim te lindjes me vonësë	10.00€
	1.24	Për regjistrim të lindjes special (lindja jashtë vendit-plus i jepet ekstrakti	2.00€
	1.25	Për regjistrim te martesës special jashtë vendit –plus i jepet certifikata	2.00€
	1.26	Për lidhje të martesës/ ceremonia	7.00€
	1.27	Për lidhje të martesës me shtetas te huaj	20.00€

1.28	Për lidhje të martesës jashtë orarit të punës brenda Komunës	80.00€
1.29	Për lidhje të martesës jashtë orarit të punës dhe jashtë Komunës	100.00€
1.30	Lirimi nga shtetësia	5.00€
1.31	Për regjistrim te vdekjes me vonësë: Deri në 5 (pesë) vite nga vdekja	5.00€
	Mbi 5 (pesë) vite nga vdekja	10.00€
1.32	Për korrigjimin të të dhënave në librat amë/regjistra, Nëse ka qen gabim i Komunës të jetë falas	5.00€ 00.00€
1.33	Për regjistrim te vdekjes speciale	0.00€
1.34	Për ndërrimin e emrit personal:	
	1.34.1 (deri në moshën 18 vjeçare)	15.00€
	1.34.2(mbi moshën 18 vjeçare)	50.00€
	1.34.3 (për pensionistet 50% zbritje)	25.00€

Neni 8

Lartësia dhe pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

1. Të gjithë personat që pajisen me certifikata zyrtare dhe dokumente tjera zyrtare nga Komuna, paguajnë taksë komunale, si në vijim:
 - 1.1. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të certifikatës apo dokumenteve zyrtare. Pa dëshmi të pagesës nuk mund të merret certifikata apo dokumenti zyrtar.
 - 1.2. Pagesa për shërbimet e kryera bëhet në llogarinë rrjedhëse të Komunës së Suharekës apo drejtëpërsëdrejti te zyrtari i autorizuar i cili obligohet që palës ti jep dëshmi mbi pagesën e bërë.
 - 1.3. Për pagesat e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni Komuna lëshon dëshminë përkatëse dhe ky vërtetim është i vlefshëm brenda gjithë vitit fiskal, në rast se kërkesa për marrje të certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nuk mund të dorëzohet pas pagesë së taksës.
 - 1.4. Për lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile për përdorim jashtë vendit, lëshohen në letër të veçantë sipas specifikave të përcaktuara nga Agjencia e Regjistrimit Civil.
 - 1.5. Për përdorim brenda vendit dokumentet e gjendjes civile lëshohen në letër të bardhë standarde të formatit A4.

Neni 9

Detyrimi lidhur me të dhënat

1. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me certifikatat e paraparë nga neni 7 i kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë të dhënat lidhur me regjistrin civil me kohë dhe t'i përditësojnë ato brenda afatit të përcaktuar ligjor.
2. Të gjitha personat që kërkojnë të pajisen me vërtetimet e parapara nga neni 7 i kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë informata të sakta lidhur me gjendjen përkatëse për të cilën pajisen me vërtetim.

Neni 10

Lirimi nga pagesa e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare e taksave komunale administrative

1. Qytetarët të cilët i përkasin kategorive të qytetarëve si në vijim: Shfrytëzuesit e ndihmës sociale; Familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së; Invalidët e luftës së UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë; Veteranët e luftës së UÇK-së dhe anëtareve të familjes së ngushtë; Personat me aftësi të kufizuara; Familjet strehuese të fëmijëve pa kujdes

prindëror, Personat me nevoja te veçanta, lirohen ngapagesa e certifikatës dhe dokumenteve zyrtare e taksave komunale administrative.

2. Lirimi nga taksat sipas kësaj Rregulloreje, bëhet pasi që pala të prezantoj dëshmi valide me shkrim për statusin përkatës.

KAPITULLI IV
Neni 11
DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE BUXHET

1. Taksat (ngarkesat) për ushtrimin e veprimtarive afariste, si më poshtë;

Nr.R	EMËRTIMI (i tarifës dhe taksave në shërbime)	Euro
1.1	Kompanitë publike nacionale	1000€
1.2	Kompanitë publike regjionale	700€
1.3	Kompanitë dhe filialet bankare	1200€
1.4	Kompanitë mikrofinancare dhe mikrokreditore	700€
1.5	Kompanitë e pagesave dhe këmbimeve	300€
1.6	Kompanitë dhe filialet e kompanive që merren me sigurimin e automjeteve, pasurisë, personave dhe sigurimeve të tjera	500€
1.7	Kompanitë që merren me sigurimin fizik	200€
1.8	Kompanitë dhe korporatat e ndryshme rentabile	1000€
1.9	Ndërmarrjet ndërtimore-ndërtimi i ulët dhe i lartë	500€
1.10	Ndërmarrjet e specializuara për ndërtim	200€
1.11	Ndërmarrësit e vegjël	100€
1.12	Prodhuesit e pijeve alkoolike	400€
1.13	Prodhuesit e pijeve joalkoolike	150€
1.14	Prodhuesit e materialit ndërtimor	300€
1.15	Prodhuesit dhe përpunuesit e lëkurës dhe materialeve të ngjashme	230€
1.16	Prodhuesit e mobilieve	230€
1.17	Prodhuesit e materialit për ambalazh nga plastika	300€
1.18	Prodhuesit e materialit për ambalazh nga letra	150€
1.19	Prodhuesit dhe përpunuesit e arit, argjendit dhe metaleve të tjera të çmuara	150€
1.20	Prodhuesit e materialit elektrik	250€
1.21	Prodhuesit e gypave PVC	250€
1.22	Prodhuesit e tekstilit, tepihëve dhe produkteve tjera të ngjashme	250€
1.23	Prodhuesit e dyerve, dritareve dhe elementeve të tjera të ngjashme nga alumini dhe plastika	300€
1.24	Prodhuesit e dyerve, dritareve dhe elementeve të tjera të ngjashme nga druri	200€
1.25	Prodhuesit e elementeve të metalit	250€
1.26	Prodhuesit e ngjitëseve dhe xhelatinës	200€
1.27	Prodhuesit e fasadave, materialeve suvatuese dhe materialet tjera përcjellëse	300€
1.28	Prodhuesit e sfungjerit dhe materialeve të tjera të ngjashme	150€
1.29	Prodhuesit e produkteve të mishit	300€
1.30	Prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit dhe produkteve nga qumështi	150€
1.31	Prodhuesit dhe përpunuesit e produkteve ushqimore	150€
1.32	Prodhuesit tjerë (produkteve higjienike, sanitare, etj)	250€

1.33	Përpunimi i drurit, llamarinës, plastikës, gurit etj	250€
1.34	Shtypshkronjat	250€
1.35	Ndërmarrjet botuese	250€
1.36	Ndërmarrjet tregtare me shumicë	300€
1.37	Ndërmarrjet tregtare me pakicë	225€
1.38	Depot e materialit ndërtimor	300€
1.39	Agjensionet turistike	200€
1.40	Transportuesit e udhëtarëve (nacional dhe ndërkombëtar)	300€
1.41	Transportuesit e udhëtarëve (komunal)	150€
1.42	Transportuesit e materialeve të rrezikshme	400€
1.43	Transportuesit e materialeve ndërtimore	250€
1.44	Transportuesit specifik	350€
1.45	Ndërmarrjet e autotaksive	250€
1.46	Ndërmarrjet e kombi-taksive	300€
1.47	Taksitë individuale (kanë një taksitë dhe punojnë pronarët)	50€
1.48	Gurëthyesit	600€
1.49	Seperacionet e rërës	500€
1.50	Hotelet	500€
1.51	Motelet	500€
1.52	Restorantet	400€
1.53	Piceritë	200€
1.54	Bifet, gjellëtoret dhe servuesit e vegjël të ushqimit	135€
1.55	Disko baret	450€
1.56	Klubet e natës	900€
1.57	DJ	50€
1.58	Grupet muzikore	150€
1.59	Kafe-çajtoret	100€
1.60	Kafiteritë	250€
1.61	Ëmbëltoret	100€
1.62	Parkingjet private (m ²)	0.35€
1.63	Kompanitë e shpedicionit	250€
1.64	Tregjet e hapura dhe të mbyllura tjera	200€
1.65	Kompanitë ndërmjetësuese në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme	300€
1.66	Kooperativat bujqësore	90€
1.67	Feramat e shpezëve dhe kafshëve	120€
1.68	Mullinjtë elektrik me industrinë e përpunimit dhe prodhimit nga mielli	250€
1.69	Mullinjtë elektrik	250€
1.70	Barnatoret bujqësore	150€
1.71	Barnatoret shëndetësore	300€
1.72	Shërbimet veterinarë	100€
1.73	Frigoriferët	50€
1.74	Mishtorët	150€
1.75	Thertoret	100€
1.76	Bukëpjekësit	150€
1.77	Përpunimi i pemëve dhe perimeve	100€

1.78	Lulishtet	50€
1.79	Pikat e karburanteve	600€
1.80	Pikat e gasit	80€
1.81	Radio	50€
1.82	TV	150€
1.83	Kiosqet	90€
1.84	Artizanatit	45€
1.85	Dyqanet	150€
1.86	Marketet	250€
1.97	Super marketet	350€
1.88	Qendrat tregtare	1200€
1.89	Tregtarët lëvizës	50€
1.90	Produksionet e artit, dizajnit, mediave dhe të tjera	150€
1.91	Autoserviset (autolimar, automekanik, autoelektrik, etj)	225€
1.92	Vullkanizorët	135€
1.93	Riparimi dhe servisimi i pajisjeve elektrike, elektronike dhe informative	100€
1.94	Autolarjet	80€
1.95	Kontrollimi teknik i automjeteve	400€
1.96	Renta Car	270€
1.97	Varrezat e automjeteve	120€
1.98	Varrezat dhe rikoperuesit e mbeturinave të metaleve	120€
1.99	Varrezat dhe rikoperuesit e mbeturinave jo metaleve	100€
1.100	Shërbimet e internetit dhe TV-kablloviqe	300€
1.101	Shërbimet e elektrikes, elektronikës, sistemeve të sigurisë etj	200€
1.102	Bastoret	2500€
1.103	Lojërat e fatit (ruletë, aparate të ndryshme etj)	5000€
1.104	Lojërat e ndryshme (bilardo, video lojëra dhe të ngjashme)	90€
1.105	Pishinat	270€
1.106	Fusha sportive të hapura	50€
1.107	Fusha sportive të mbyllura	150€
1.108	Shërbimet e pastrimit	200€
1.109	Dhënia me qira e mjeteve të punës	180€
1.110	Riparimi i makinave të imëta	70€
1.111	Floktarët për meshkuj dhe për femra	150€
1.112	Sallonet e ondulimit	250€
1.113	Fotografët	100€
1.114	Pastrim kimik	100€
1.115	Përpunuesit e mermerit dhe granitit	200€
1.116	Veprimtaritë tjera profesionale	135€
1.117	Ndërmarrjet e tjera shërbyese	135€
1.118	Agjensionet tjera profesionale	135€
1.119	Avokatët	250€
1.120	Shërbimet juridike	150€
1.121	Përkthyesit	100€
1.122	Ordinancat mjekësore private	300€

1.123	Klinikat mjekësore	500€
1.124	Laboratorët	300€
1.125	Autoshkollat	150€
1.126	Rëntgenit	300€
1.127	Dentistet	300€
1.128	Noterët	400€
1.129	Shërbimet e kontabilitetit dhe financave	120€
1.130	Auditorët	250€
1.131	Kompanitë projektuese	250€
1.132	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	150€
1.133	Arsimi fillor	150€
1.134	Arsimi i mesëm	250€
1.135	Arsimi universitar	400€
1.136	Arsimi tjetër dhe kurset	50€
1.137	Librarit	50€
1.138	Fizioterapeutet	300€
1.140	Fitneset në ambiente të mbyllura	150€
1.141	Fitneset në ambiente të mbyllura	60€
1.142	Kompanitë që merren me vlerësim të demit dhe sigurisë	200€
1.143	Vlersuesit e licencuar për vlersime të ndryshme	200€
1.144	Gjeodete dhe ndërmarrjet merren matje gjeodetike	200€
1.145	Ndërmarrjet që merren me rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve	200€
1.146	Rrobapset	100€
1.147	Ndërmarrjet që merren qepje dhe shitje të produkteve të tekstilit	200€
1.148	Shitja dhe servisimi i telefonave mobil dhe pajisjetpercjellse të tyre	200€
1.149	Aktivitetet e lojrave të ndryshme për fëmijë	200€

2. Duke u bazuar në specifikat e ndryshme ekonomike të komunës e cila ndikon në afarizmin e bizneseve në komunën e Suharekës janë përcaktuar; **5 zona që i referohen zoonimit të Rregullores së tatimit në pronë**, zona nga II deri në V, kanë zbritje si më poshtë:

- 2.1 Zona I ngarkohet sipas ngarkesave në listën e aktiviteteve
- 2.2 Zona II ngarkohet me zbritje 15% nga ngarkesa në listën e aktiviteteve
- 2.3 Zona III ngarkohet me zbritje 25% nga ngarkesa në listën e aktiviteteve
- 2.4 Zona IV ngarkohet me zbritje 35% nga ngarkesa në listën e aktiviteteve
- 2.5 Zona V ngarkohet me zbritje 50% nga ngarkesa në listën e aktiviteteve

3. Tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare në DEFB-në;

3.1	Certifikatat mbi kryerjen e obligimeve dhe Certifikata të ngjashme	1.00€
3.2	Certifikatat për kursime pensionaleinvalidore (zejtarët).	1.00€
3.3	Certifikata për gjendjen ekonomike dhe financiare	1.00€
3.4	Për mbajtjen e muzikës në lokale publike paguhet taksa ditore	15.00€
3.5	Kërkesat për zvogëlimin e tarifë ngarkesave	1.00€
3.6	Kërkesa për veretetim mbi të ardhurat dhe kërkesat tjera që kërkojnë për jashtë vendit	5.00€

4. Tarifat për lejet e pronësisë së automjeteve;

4.1 Të gjithë pronaret, bizneset ose entitete tjera që kanë në pronësi të tyre të gjitha llojet e automjeteve motorike që regjistrohen dhe paguajnë sigurimin e automjeteve brenda vitit i caktohet tarifa më sa vijon:

4.1.1	Automjetet deri në 3.5 ton ngarkohen	10.00€
4.1.2	Automjete mbi 3.5 ton ngarkohen	20.00€
4.1.3	Autobusët	25.00€
4.1.4	Motoçikletat	5.00€
4.1.5	Rimorkiet e automjeteve mbi 3.5 ton	10.00€
4.1.6	Rimorkiet e automjeteve deri 3.5 ton	5.00€
4.1.7	Makinat bujqësore	3.00€

4.2 Taksa për lëshimin e lejes së lartpërmendur do të paguhet në Komunë me ngarkesë dhe në bazë vjetore ose me rastin e regjistrimit të automjeteve në qendrën për regjistrimin e automjeteve.

4.3 **Vërejtje:** Nga tarifa për leje të automjeteve motorike lirohen të gjitha automjetet e emergjencës (zjarrfiksat dhe makinat e ndihmës së shpejtë), familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe personat me aftësi të kufizuar dhe automjetet në pronësi të Komunës. Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit.

5. Tarifa për parkimin e automjeteve,

5.1	Tarifa për automjetet motorike deri në 3.5 t për një orë	0.50€
5.2	Tarifa për automjetet motorike mbi 3.5 t për një orë	1.00€

Neni 12

Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese dhe Lirimi nga pagesa për bizneset)

1. Të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetet ekonomike ngarkohen me taksa në aktivitet të veprimtarisë primare të aktivitetit ekonomik (**100% nga tarifa bazë**).
2. Të gjitha subjektet afariste që veprojnë në Komunën e Suharekës, ndërsa selinë e kanë jashtë Komunës së Suharekës nuk përjashtohen nga taksat dhe ngarkohen me taksën bazë.
3. Bizneset afariste që operojnë në shumë lokacione mbrenda komunës, me firmë dhe aktivitet të njëjtë por me njësi të ndryshme ngarkohen me **50%** për çdo njësi, përveç njësisë kryesore që ngarkohet me taksën bazë.
4. Bizneset e reja lirohen nga taksa për ushtrim të vepritarisë afariste për një vit nga data e regjistrimit.
5. Bizneset e reja që regjistrohen në emer të grave dhe të rinëve nën moshën 25 vjeçare lirohen nga taksat **50%** për **3 vite**.
6. Bizneset e reja Artizanale që regjistrohen për ushtrim të aktivitetit afarist në territorin e komunës lirohen nga taksat.
7. Bizneset të cilat dëshmojnë dokumente sigjendaj tatimore nga ATK-jase nuk kanë ushtruar aktivitetin ekonomik prej themelimit të tyre apo për periudha të caktuara (**TM1/TM2/TM3/TM4**) dhe në qoftë se nuk kanë asnjë deklaramë apo kanë deklarime me **0.00** qarkullim dhe që vërtetohet nga komisioni prej komunës, lirohet nga taksa në aktivitet për periudhat me qarkullim **0.00 €** ndërsa ato të cilat nuk kanë deklarime fare nuk ngarkohen për

vitet vijuese(**konsiderohen si biznese pasive**), por në qoftë se haset gjatë vizitave në teren se biznesi punon atëherë automatikisht ngarkohet në bazë të qarkullimit të vertetur nga ATK-ja.

8. Bizneset që ushtrojnë aktivitetet të pastër të bujqësisë dhe blegtorisë lirohen nga taksa për ushtrim të aktivitetit afarist për **10 vitet** e ardhshme duke filluar nga viti **2024**.
9. Bizneset që merren me veprimtari specifike dhe që janë të obliguara të kenë licenca profesionale janë të detyruara të pajisen me licenca.

Neni 13

Ankesat kundër taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Kundër vendimit të lëshuar nga DEFB-ja me taksë komunale për ushtrimin e veprimtarisë, pala e pakënaqur ka të drejtë të kërkoj shqyrtimin e vendimit brenda 30 ditëve nga dita e pranimit duke ju drejtuar organit që ka nxjerrë vendimin.
2. Pala e pakënaqur me vendimin e DEFB-së për ngarkesa dhe taksa komunale ka të drejtë ankese brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, t'i drejtohet Komisionit Komunal për Shqyrtimin e Ankesave i formuar nga Kryetari i Komunës (Zyrtari më i lartë Administrativ).

KAPITULLI V

Neni 14

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

1. Tarifat në sferën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, kjo Drejtori realizon këto të hyra për tarifa nga qytetarët e Komunës së Suharekës:

Nr.	EMËRTIMI	Euro
1.1	Vërtetimi për nxënës dhe studentë për botën e jashtme:	5.00€
1.2	Vërtetimet mbi gjendjen shëndetësore të punëtorëve në botën e jashtme:	8.00€
1.3	Vërtetimet e llojeve të ngjashme të tjera (nga lemija shëndetësore)	8.00€
1.4	Raporte konziliare të mjekëve për punëtor në botën e jashtme:	15.00€
1.5	Formulari për shpenzimet e varrimit	5.00€
1.6	Formular për pensionistet që kanë vendim të pensionit deri në 100€	1.00€
1.7	Formular për pensionistet që kanë vendim të pensionit mbi në 100€	5.00€

Neni 15

Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese Lirimi nga tarifa)

1. Qytetarët të cilët i përkasin kategorive të qytetarëve si në vijim: Shfrytëzuesit e ndihmës sociale; Familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së; Invalidët e luftës së UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë; Veteranët e luftës së UÇK-së dhe anëtarëve të familjes së ngushtë; Personat me aftësi të kufizuara; Familjet strehuese të fëmijëve pa kujdes prindëror, lirohen nga pagesa e vërtetimit dhe dokumenteve zyrtare e taksave komunale administrative.
2. Gjithashtu studentët përkatësisht deri në moshën 26 vjeçare dhe nxënësit lirohen nga pagesa në tarifë ngarkesa që kanë lidhje me shkollimin e tyre.
3. Lirimi nga tarifa sipas kësaj Rregulloreje, bëhet pasi që pala të prezantoj dëshmi valide me shkrim për statusin përkatës.

Neni 16
Tarifat në Qendrën për Punë Sociale-QPS

1. Lloji i shërbimit:

1.1	Vërtetim për posedim të zotësisë së veprimi për paisje për leje te armës	8.00 €
1.2	Vërtetim për posedim të zotësisë së veprimi për punësim	1.00 €
1.3	Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës që nuk ka obligime financiare	5.00 €
1.4	Vërtetim për praninë të shtetësisë së Kosovës	1.00 €
1.5	Vërtetim për palën se nuk është shfrytëzues/e i/e ndihmës sociale	1.00 €
1.6	Vërtetim për palën se ka qenë shfrytëzues/e i/e ndihmës sociale	1.00 €
1.7	Vërtetim për palën se nuk është shfrytëzues/e i/e ndihmës sociale-për shtet e jashtëm	5.00€
1.8	Pëlqim për martesë para moshës madhore	5.00€
1.9	Vërtetim për regjistrim të mëvonshëm të fëmijës	3.00€
1.10	Vërtetim që është duke u kujdesur për fëmijët	1.00€

Neni 17

Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese Lirimi nga tarifa)

- Qytetarët të cilët i përkasin kategorive të qytetarëve si në vijim: 1.1 Shfrytëzuesit e ndihmës sociale; 1.2 Familjet e dëshmorëve të UÇK-së; 1.3 Invalidët e luftës së UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë; 1.4 Veteranët e luftës së UÇK-së dhe anëtarëve të familjes së ngushtë; 1.5 Personat me aftësi të kufizuara;
- Lirimi nga taksat sipas kësaj Rregulloreje, bëhet pasi që pala të prezantoj dëshmi valide me shkrim për statusin përkatës.

Neni 18

**QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE “REXHEP KUÇI” (QKMF-ja)
NËSUHAREKË**

Me anë të kësaj rregullore përcaktohen dhe sigurohen të gjitha të hyrat financiare nga bashkë pagesat që realizohen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare Rexhep Kuçi” në Suharekë, nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, si dhe dispozitat e veçanta me anë të cilave parashihen kategoritë e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore që përjashtohen nga këto bashkë pagesa. Me dispozita ligjore dhe udhëzime administrative në fuqi shfrytëzuesit potencial (që në ndonjë mënyrë nuk janë liruar nga shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore) janë të obliguar të paguajnë taksën për ofrimin e shërbimit shëndetësor në QKMF. Këta shfrytëzues të shërbimeve shëndetësore obligohen të participojnë për këto shërbime të paraqitura në mënyrë tabelore, si më poshtë:

1. Tarifanë mjekësinë e përgjithshme;

Nr.r	EMËRTIMI (i tarifës dhe taksave në shërbime)	Euro
1.1	Ekzaminimi mjekësor nga mjeku i prekësës së përgjithshme (doktori i mjekësisë)	1.00€
1.2	Ekzaminimi mjekësor nga specialisti i mjekësisë familjare	2.00€
1.3	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të mjekut të familjes	5.00€
1.4	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6.00€
1.5	Medikamenti nga Lista Esenciale, ofruar në barnatoren publike	0.30€
1.6	Ultrazëri standard	2.00€
1.7	Radiografia	2.00€
1.8	EKG	0.50€
1.9	Analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina	1.00€
1.10	Analizat laboratorike (komplet)	3.00€
1.11	Analiza laboratorike komplet me test reumatike ose elektrolite	3.00€
1.12	Përcaktimi i TSH, T3 dhe T4	3.00€
1.13	Hemoglobina e glukoziguar HaA1C	3.00€

1.14	Analiza laboratorike HBA 1c	3.00€
1.15	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometer sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00€
1.16	Audiograma	1.00€
1.17	Shpëlarja e veshit	1.00€
1.18	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.00€
1.19	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.00€
1.20	Dhënia e infuzionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente	1.00€
1.21	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërimin e plagës (vetëm në vizitën e parë)	3.00€
1.22	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00€
1.23	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18.00€
1.24	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00€
1.25	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj-për një orë	25.00€
1.26	Certifikata shëndetësore për regjistrim në çerdhe ose kopsht fëmijësh <i>(Lirohen nga pagesa në sektorin publik bazuar në ligjin për shëndetësi, përjashtohen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj)</i>	10.00€
1.27	Certifikata shëndetësore për regjistrim në shkolla fillore, të mesme, të larta, fakultete dhe nivele tjera të shkollimit <i>(Lirohen nga pagesa në sektorin publik bazuar në ligjin për shëndetësi, përjashtohen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj)</i>	10.00€
1.28	Certifikata shëndetësore për regjistrim në shkolla të veçanta të të gjitha niveleve dhe shkolla të tjera, për profesione të veçanta. <i>(Lirohen nga pagesa në sektorin publik bazuar në ligjin për shëndetësi, përjashtohen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj)</i>	10.00€
1.29	Certifikata shëndetësore për punësim	15.00€
1.30	Certifikata shëndetësore për punësim në vende me kushte të veçanta pune	50.00€
1.31	Certifikata shëndetësore për punë profesionale në lëmin e komunikacionit	50.00€
1.32	Certifikata shëndetësore për paisje me patent shofer për kategoritë: A1, A, B1, B, BE, M, L dhe T	20.00€
1.33	Certifikata shëndetësore për paisje me patent shofer për kategoritë: C1, C, D1, D, C1E, CE, D1E dhe DE	50.00€
1.34	Certifikata/Librezë shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të sportistëve në sportin amator <i>(Lirohen nga pagesa në sektorin publik bazuar në ligjin për shëndetësi, përjashtohen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj)</i>	10.00€
1.35	Certifikata shëndetësore për aftësin psiko-fizike të bashkëshortëve për adaoptimin e fëmijës	50.00€
1.36	Çdo pacienti të cilit i ofrohet shërbim shëndetësor në urgjencë nga ora 20 ⁰⁰ deri në ora 8 ⁰⁰ pa marr parasysh moshën, (lirohen vetëm ata që i liron ligji)	2.00€
1.37	Transportimi i pacientit brenda Republikës së Kosovës dhe jashtë Republikës së Kosovës, gjendja e të cilit kërkon transport dhe kujdes profesionale shëndetësor bëhet me autoambulancë pa pagesë	Falës

Neni 19

1. Tarifa në shërbimet stomatologjike;

Nr.	EMËRTIMI (i tarifës dhe taksave në shërbime)	Euro
1.1	Vizita nga mjeku i stomatologjisë	1.00€
1.2	Vizita nga specialisti i stomatologjisë (ortodonti, pedodontietj)	2.00€
1.3	RTG i dhëmbit	1.50€

1.4	Mbushja e përhershme me amalgamë	4.00€
1.5	Mbushja e përhershme me kompozitë	5.00€
1.6	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00€
1.7	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00€
1.8	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00€
1.9	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00€
1.10	Extirpimimortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00€
1.11	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00€
1.12	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	6.00€
1.13	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00€
1.14	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00€
1.15	Vulosja e fisurave	1.00€
1.16	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00€
1.17	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurësve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00€
1.18	Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmbë)	1.00€
1.19	Nxjerrja e dhëmbit	1.50€
1.20	Incizoni intra dhe ekstra oral	1.50€
1.21	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00€
1.22	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.50€

Neni 20

Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese apo liruese);

1. Përfshirimi nga bashkë pagesat (tarifë ngarkesave) Shërbimet shëndetësore dhe grupet e popullatës që janë të liruar nga bashkë pagesat janë:

- 1.1 Fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 15 vjeçare;
- 1.2 Nxënësit dhe studentët deri në fund të shkollimit të tyre, përkatësisht deri në moshën 26 vjeçare;
- 1.3 Qytetarët mbi moshën 65 vjeçare;
- 1.4 Anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës dhe llojet e tjera të invaliditetit, anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, si dhe shfrytëzuesit e skemave të përgjithshme të përkrahjes sociale dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre;
- 1.5 Veteranet e luftës kategoritë e parapara sipas Ligjit për veteranet e luftës i aplikueshëm në Republikën e Kosovës;
- 1.6 Personat me aftësi të kufizuara;
- 1.7 Kujdesi shëndetësor parandalues;
- 1.8 Kujdesi shëndetësor reprodaktiv, që përfshin masat e planifikimit të familjes dhe kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonisë;
- 1.9 Kujdesi shëndetësor për pacientet të cilët lëngojnë nga sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet të cilat rrezikojnë seriozisht ose vështersojnë jetën e tyre, (të përcaktuar nga IKSHP-ja dhe Ministria e Shëndetësisë);
- 1.10 Sëmundjet infektive të përcaktuar nga IKSHP-ja dhe Ministria e Shëndetësisë, në listen e sëmundjeve infektive;
- 1.11 Kategori tjera sipas diagnozës (të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë);
- 1.12 Kujdesin shëndetësor për qytetarin në stadin terminal që duhet të ofrohet në shtëpinë e qytetarit nga ana e Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe pacientet me sëmundje të rënda kronike;
- 1.13 Psikoza;
- 1.14 Certifikatat e gjendjes shëndetësore të nevojshme për vijimin e rregullt të vitit mësimor në të gjitha nivelet e arsimimit, (përfshihen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj).

KAPITULLI VI
Neni 21
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MJEDIS

1. Taksat (tarifat) e përgjithshme;

1.1. Taksa administrative për lëshimin e lejeve për shndërrim të banesave në lokale afariste, dhe lokaleve afariste në banim	10.00 €/m²
1.2. Ndërtimi i objekteve të infrastrukturës. Për aktin me të cilën lejohet kyçja në infrastrukturën komunale si: rrjetë ujësjellësi, rrjetë kanalizimi rrjetë kablovike e tensionit të ulët (si tërësi për Aktvendim), sipas nenit 1.2.1 dhe 1.2.2 të kësaj rregullore paguhet:	
1.2.1 për persona fizik	15.00€
1.2.2 për personin fizik që ka biznes individual	50.00€
1.2.3 për persona juridik	50.00€
1.3. Për aktin me të cilën lejohet grupimi për ndërtimin të infrastrukturës si:	
1.3.1 Rrjetë ujësjellësi	0.40 € /m
1.3.2 Rrjetë kanalizimi	0.40 € /m
1.3.3 Rrjetë rrugore	0.40 € /m
1.3.4 Rrjet elektrik- Infrastrukturë nëntokësore	0.40 € /m
Infrastrukturë mbitokësore (Ajrore)	0.50 € /m
1.3.5 Për vendosjen e Paneleve Solare Kjo tarif nuk aplikohet për panelatsolare që janë të liruar sipas Udhëzimit Administrativ.	2.0 % e vlerës investive
1.4 Për aktin me të cilën lejohet grupimi për ndërtimin e trasave kablovike dhe ajrore të infrastrukturave si:	
1.4.1 Rrjetë telekomunikacioni dhe televizive	0.80 €/m
1.4.2 Rrjetë termofikimi	0.40 €/m
1.4.3 Rrjet Kablovik (Internet), Infrastrukturë nëntokësore	0.30 € /m
Infrastrukturë mbitokësore (Ajrore)	0.50 € /m
1.5. Për aktin me të cilën lejohet ndërtimi i objekteve të infrastrukturës si:	
1.5.1 Antena(GSM)	500.0 € /cope
1.5.2 Antena – internet e të ngjashme	200.0 € /cope
1.6. Tarifa ngarkesat për bizneset që furnizojnë dhe që furnizohen	
1.6.1. Tarifa ngarkesat për bizneset që veprojnë në zonën urbane: Parking i përkohshëm për furnizim me material – pagesa mujore	20.0 €
1.6.2. Tarifa ngarkesat për furnitorët të cilët furnizojnë bizneset që veprojnë në zonën urbane: Parking i përkohshëm për furnizim me material – pagesa mujore	50.0 €
1.7. Tarifa për dhënien e pëlqimeve dhe vërtetimeve të ndryshme	
1.7.1. Dhënia e pëlqimit për paralizim të pronave (për parcele)	15.00 €
1.7.2. Zgjatja e afatit të kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit	20.00 €
1.7.3. Dhënia e ekstrakteve nga zgjidhjet urbanistike ,vërtetimeve të ndryshme dhe shërbimeve tjera	10.00 €
1.7.4. Pëlqimet të ndryshme	15.00 €
1.7.5 Për renovime të brendshme dhe të jashtëm të objekteve	2.0 % e vlerës investive
1.8 Tarifa për shfrytëzim të sipërfaqeve (hapësirave) publike sipas zonave paguajnë tarifën mujore si vijon;	
A. Zona e I-rë: (përfshinë hapësirat publike që kanë qasje direkte në rr. Brigade 123, Hajdin Berisha, XhavitSyla dhe Skënderbeu)	
1.8.1 objektet hoteliere, ëmbëltoare etj.(para objektit)	3.00 €/m²

1.8.2 aparatet për pomfrit, krofne, palagaqaetj	4.50 €/m ²
1.8.3 aparatet për akullore dhe ruajtjen e tyre	6.00 €/m ²
1.8.4 auto-dyqanin lëvizës	6.00 €/m ²
1.8.5 ormanët MDF-pikat shpërndarëse te internetit	10.00 €/m ²
1.8.6 gjeneratorët statik	5.00 €/m ²
1.8.7 tendat(çadrat) e hapura lëvizëse me mekanizëm	1.00€/m ²
1.8.8 vendosja e lojërave të fëmijëve, tarifa vjetore	3.0 €/m ²
1.8.9 foltoret telefonike	10.00 €
1.8.10 tendat për shitjen e produkteve të ndryshme	3.00 €/m ²
1.8.11 për shfrytëzim të hapësirës publike për parking	3.00 €/m ²
B. Zona II –të (përfshinë hapësirat publike që kanë qasje në rrugët Xhavit Bajraktari, Besim Ndreca, Rruga e Zonës Industriale, KenanHalimi, Zekë Bajraktari si dhe hapësirat publike të cekura në Zonën I po që nuk kanë qasje direkte në rrugë e specifikuar të zonës 1.) tarifa zbritet për 20 % dhe Zona III (përfshinë të gjitha hapësirat publike të cilat nuk janë specifikuar në zonën I dhe II duke përfshirë edhe hapësirat publike komunale në vendbanimet rurale) tarifa zbritet për 25 %.	
1.9 Për ekspozimin e panove reklamuese paguhen tarifat vjetore si më poshtë:	
1.9.1 Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve në qytet	40 €/m ²
1.9.2 Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve me ndriçim në qytet	50 €/m ²
1.9.3 Ekspozimi i panove reklamuese jashtë zonës Urbane	15 €/m ²
1.9.4 Ekspozimi i panove reklamuese me ndriçim jashtë zonës Urbane	20 €/m ²
1.9.5 Ekspozimi i reklamave në automjete	10 €/m ²
1.10.6 Vendosja e ekraneve elektronike reklamuese	60 €/m ²
1.9.7 Vendosja e reklamave në shtyllat e ndriçimit publik: 1. Tarifa mujore 2. Tarifa ditore	30 €/m ² 5.00 €/m ²
1.9.8. Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve sipas pozitave të lartpërmendura në pronat private paguhet 50 % e vlerave të lartpërmendura.	
1.10. Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike për aparatet dhe shtatoret e lojërave argëtuese, kompensimi paguhet si vijon:	
1.10.1 Për vendosjen e cirkut tarifa ditore është	Deri në 30m ² pagesa është 20€, mbi 30m ² pagesa është 30€.
1.10.2 Për vendosjen e të gjitha llojeve të aparateve e shtatoreve tjera të lojërave argëtuesetarifa ditore është:	Deri në 30m ² pagesa është 20€, mbi 30m ² pagesa është 30€.
1.10.3 Marketingu, tendat për promovimin e produkteve, pavijonet tarifa ditore.	10.00€
1.10.4 Pagesa ditore për shitësit Ambulant (Shitjen e luleve dhe gjërave tjera të ngjajshme) 1.00 deri në 20.00 m2	20.00€
1.11 Për dalje në vend ngjarje sipas detyrës zyrtare dhe me kërkesën e palëve, bëhet kompensimi për shërbime urbanistike:	
1.11.1 Për persona fizik	10.00 €
1.11.2 Për personin fizik qe ka biznes individual	25.00 €
1.11.2 Për persona juridik, ndërmarrje etj	40.00 €
1.12 Tarifa për tu pajisur me Leje Mjedisore Komunale aplikuesi duhet të paguaj, për projektet:	
1.12.1 në vlereninvestive të projektit deri në 25.000€, paguhet tarifa në vlerë prej 50€	

1.12.2 në vlereninvestive të projektit mbi **25.000€**, paguhet tarifa **0.2%** të vlerës investive të projektit.

1.13 Tarifa përkopje të dokumenteve të planifikimit hapësinore;

1.13.1 deri në 10 faqe (A4) pa pages mbi 10 faqe tarifa është **0.20€** për një faqe me ngjyra

1.13.2 deri në 10 faqe (A4) pa pages mbi 10 faqe tarifa është **0.04€** për një faqe bardhë e zi

1.13.3 deri në 10 faqe (A3) pa pages mbi 10 faqe tarifa është **0.50€** për një faqe me ngjyra

1.13.4 deri në 10 faqe (A3) pa pages mbi 10 faqe tarifa është **0.10€** për një faqe bardhë e zi

Neni 22

Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese), për rregullimin e tokës ndërtimore nuk do të paguhet;

1. Për objektet e vjetra (që kanë poseduar leje ndërtimi më parë) dhe të dëmtuara nga lufta e të ngritura legalisht për të njëjtin gabarit, kurse për diferencën po.
2. Për objektet arsimore, administrative, sportive, shëndetësore si dhe qendrat rekreative që ndërtohen me mjete buxhetore, investime të komunitetit apo me donacione të organizatave e që janë në interes të përgjithshëm.
3. Për objektet e kultit fetar, varreza, lapidare, sipërfaqe të hapura, gjelbërim, për parking publik, sheshe, rrugë dhe sipërfaqe për gjelbërim publik.
4. Bujqit lirohen nga të gjitha tarifat e lartcekura përfshirë edhe taksat administrative dhe taksat për rregullim të infrastrukturës për ndërtimin e objekteve bujqësore (Fermat).
5. Për shfrytëzim të hapësirës publike për çështje humanitare të lirohen nga taksa komunale dhe administrative (duke i përfshirë organizata jo fitimprurëse dhe të huaja).

KAPITULLI VII

Neni 23

DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI

1. Tarifa për ndërrimin e destinimiti përhershëm të tokës bujqësore;

Nr.	Emërtimi i kategorisë së tokës	Vlera
1.1	Kategoria e parë e tokës \ klasë e I-IV	1.00 € \ m²
1.2	Kategoria e dytë e tokës \ klasë e V-VI	0.75 € \ m²
1.3	Kategoria e tretë e tokës \ klasë e VII-VIII	0.50 € \ m²

2. Për ndërrimin e përkohshëm të destinimit të tokës bujqësore do të paguhet kompensimi 20% nga taksat e destinimit të përhershëm, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

3. Tarifa për shërbimet profesionale në përzgjedhjen dhe damkimin e trungjeve dhe lëshimin e lejeve për prerje në pyjet private dhe publike;

- 3.1 Damkimi i trungjeve për prerje në pyjet private, bëhet nga Agjencioni i Pyjor i Kosovës në pajtim me planet vjetore të menaxhimit dhe në pajtim me mundësitë vjetore të shfrytëzimit të ngastrave.
- 3.2 Të gjitha procedurat e lëshimit të lejes për prerje në pyjet private duke përfshirë shqyrtimin e kërkesës, dhënien e lejes për prerje, shënjimin e asortimentit për transport dhe lëshimin e flet përcjelljes udhëhiqen nga Autoriteti Pyjor Komunal.
- 3.3 Për përzgjedhjen, damkimin dhe lëshimin e lejeve për prerjen e trungjeve të klasifikuara si asortiment teknik (industrial)dhe për trungje të klasifikuara si dru për dëgjie , do të zbatohen tarifat si në vijim:

4. **Taskat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private, dhënë e pëlqimeve, vërtetimeve nga lëmia e bujqësisë dhe pasurive tjera bujqësore:**

Nr.	Kategorizimi i dokumentit	Vlera në €
4.1	Fletëpagesa për damkosje të druve në pyje private me $v=7m^3$	1.50 € \ m ³
4.2	Fletëpagesa për damkosje të druve në pyje private me $v = mbi 7m^3$	2.00 € \ m ³
4.3	Fletëpagesa për dru teknik (industrial) për m ³	3.00€ \ m ³
4.4	Fletëpagesa për pyje publike- dru të thata-holla d=7cm	11.00€ \ m ³
4.5	Fletëpagesa për pyje publike-dru të thata- trasha mbi d=7cm	15.00 € \ m ³
4.6	Për punën e komisionit në vlerësimin e dëmit, Pyllit, Vreshtave, Pemishteve, Kulturave Lavërtarë, Bagëtisë, dhe pasurive tjera,	10.00 €
4.7	Vërtetim për shitjen e prodhimeve bujqësore në treg për një vit	15.00 €
4.8	Vërtetim për Bujqësi- për rregullimin e vizave turistike	5. 00 €
4.9	Vërtetimi për bartjen e kafshëve për kokë	1.00€
4.10	Trajtimi i qenve endacak dhe shtëpiak me kërkesë të pronarit	10.00 €
4.11	Vërtetim për të dëshmuar se një fermer merret apo është marrë me aktivitet bujqësore	3.00€
4.12	Për lëshimin e ç' do vërtetimi e që nuk është parapare këto tarifa dhe ngarkesa	3.00€

5. **Taksa vjetore për shfrytëzimin e kullotave për bagëtitënë pyje dhe toka pyjore publike është:**

Nr.	Lloji i bagëtisë	NB/kokë	EURO/kokë
5.1	Gjedhe mbi një vit	1	1.20 € \ copë
5.2	Viça	0.45	0.54 € \ copë
5.3	Dele	0.18	0.22 € \ copë
5.4	Qengja	0.1	0.12 € \ copë
5.5	Kuaj dhe gomarë	1	1.20 € \ copë
5.6	Derra	0.3	0.36.€ \ copë
5.7	Rosat	0.014	0.02 € \ copë.
5.8	Dosat	0.5	0.60€ \ copë

6. Përpos taksave dhe ngarkesave të caktuar në nenin 23, paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje do të aplikohen edhe taksat që caktohen nga Ministria përkatëse me aktet nën ligjore të aplikueshme.

KAPITULLI VIII

Neni 24

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

1. **Taksat për lëshimin e dokumenteve zyrtare;**

1.1 Shpenzimet për dalje të organeve të inspekcionit të nivelit lokal në terren me kërkesën e palës për shiqimin e objekteve (lokale të punës, pajisjeve, veglave, stabilimenteve etj) të parapara me dispozitat për kushtet minimale higjenik–sanitare dhe teknike, mbrojtjes së mjedisit i bartin parashtruesi i kërkesës si vijonë;

Nr.R.	<i>EMËRTIMI (i tarifave dhe taksave në shërbime)</i>	Euro(€)
1.1.1	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe deri në 20 m ²	20.00€
1.1.2	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 20-50 m ²	30.00€

1.1.3	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 50-100 m ²	40.00€
1.1.4	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 100 m ²	100.00€
1.1.5	Pëlqim komunikacioni	60.00€
1.1.6	Pranim teknik për auto taksì.	30.00€
1.1.7	Kërkesë për kontroll inspektues për personat fizik	10.00€
1.1.8	Kërkesë për kontroll inspektues për personat fizik që ka te regjistruar biznes (individual) në bazë të legjislacionit në fuqi	15.00€
1.1.9	Kërkesë për kontroll inspektuese për subjekt afarist (persona juridik) dhe institucionet tjera	20.00€
1.1.10	Kërkesë për asgjësim të mallrave	30.00€
1.1.11	Kërkesë për dalje në terren nga ndërmarrjet publike dhe kompanitë tjera simotra ose të ngjashme	100.00€

2. Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për Linjat Urbane dhe Autotaxi;

2.1 Çdo Operator i transportit publik të udhëtarëve pas pajisjes me licencë, obligohet të pajiset edhe me rend udhëtimit, paguan taksën vjetore për vija urbane dhe urbane-periferike.

2.2 Çdo person fizik dhe juridik që ka të regjistruar ushtrimin e veprimtarisë taxi shërbime duhet të pajiset me leje pune dhe paguan taksën vjetore për leje pune.

2.3 Operatorët dhe personat fizik përcaktuar në paragrafin një dhe dy (1 dhe 2) të këtij neni, taksën e paguajnë para marrjes së rendit të udhëtimit dhe lejes së punës sipas legjislacionit në fuqi.

2.3.1	Transportuesit e udhëtarëve për një vijë (linjë) vajtje-ardhje, për çdo një kilometer (km) takësen vjetore	0.50 €
2.3.2	Leja punës për taksì takësen vjetore	20.00€
2.3.3	Aplikacioni për një vijë urbane	3.00 €

KAPITULLI IX

Neni 25

DREJTORIA PËR ARSIM

1. Tarifat e përgjithshme të arsimit;

1.1	Tarifa mujore për një fëmijë në çerdhe publike	30.00€
1.2	Tarifa për regjistrimin e vitit shkollor për arsimin profesional për të rritur	100.00€
1.3	Tarifa për provim përfundimtar/certifikatën-diploma në (IAAPARR)	50.00€
1.4	Tarifa për praktikë profesionale	50.00€
1.5	Tarifa për provimin diferenciale	10.00€
1.6	Tarifa për dokumentet duplikat për shkollimin para universitar për çdo dokument paguhet	1.00€

Neni 26

Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese apo liruese);

1. Kur familja ka dy fëmijë në institucionin parashkollor do të paguajë, për njërin tarifën e plotë, ndërsa për të dytin 30 % më pak.

2. Nëse familja ka 3 fëmijë në institucionin parashkollor, për të tretin do të paguajë 50 % të tarifës.

3. Për çdo zbritje të tarifave kompensimin e bën DKA-ja.

KAPITULLI X
DREJTORIA PËR SHËRBIME, PRONSORO-JURIDIKE DHE KADASTËR

Neni 27

Regjistrimi i të drejtës së pronësisë në bazë të vlerës së transksioneve

1. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas vlerës së transaksioneve janë:

- 1.1. deri në dhjetëmijë (10.000)€ tridhjetë **(30) €**.
- 1.2. prej dhjetëmijë e një (10.001)€ deri në pesëdhjetë mijë (50.000)€.....pesëdhjetë **(50) €**.
- 1.3. prej pesëdhjetëmijë e një (50.001) € deri në njëqindmijë (100.000)€ shtatëdhjetë **(70) €**.
- 1.4. prej njëqindmijë e një (100.001) € deri në dyqindmijë (200.000) €nëntëdhjetë **(90) €**.
- 1.5. prej dyqindmijë e një (200.001) € deri në pesëqindmijë (500.000) €njëqind e njëzet **(120) €**.
- 1.6. prej pesëqindmijë e një (500.001) € deri në njëmilion (1.000.000) €dyqind e katërdhjetë **(240) €**.
- 1.7. mbi vlerën e njëmilion (1.000.000) € tarifa pesëqind **(500) €**.
- 1.8. Për vlerën e kontratës - transaksionit që është vërtetuar para vitit 1999 tarifapesëdhjetë **(50) €**.
- 1.9. Lirohet nga pagesa rastet kur kemi të bëjmë me ri regjistrim të pronave të paluajtshme në kadastër.

2. Tarifat e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, zbatohen në të gjitha rastet kur nuk është e përcaktuar me dispozitë të veçantë tarifa për regjistrim.

Neni 28

Tarifa e regjistrimit të pronësisë, në bazë të kontratës mbi dhuratën

- 1. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së dhurimit për çdo anëtarë të ngushtë të familjes,tridhjetë **(30) €**.
- 2. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së dhurimit për çdo person që nuk është anëtarë i familjes dhe që nuk është e caktuar vlera e pronës,tetëdhjetë **(80) €**.
- 3. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës për dhurimin e pronës së paluajtshme, në të cilën është caktuar vlera e pronës dhe dhuratëmarrës nuk është anëtarë i familjes zbatohet tarifa sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje.

Neni 29

Tarifa e regjistrimit të pronësisë, në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përrjetshme

- 1. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përrjetshme për personin që është anëtarë i familjes,tridhjetë **(30) €** për çdo pronar.
- 2. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përrjetshme për personin që nuk është anëtarë i familjes dhe nuk është e caktuar vlera e pronës,.....tetëdhjetë **(80) €**.
- 3. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës për mbajtjen e përrjetshme, në të cilën është caktuar vlera e pronës dhe mbajtës nuk është anëtarë i familjes zbatohet tarifa sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje.

Neni 30

Tarifa e regjistrimit të pronësisë apo të drejtave tjera sendore në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore

Tarifa për regjistrimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme apo të drejtave tjera sendore në bazë të vendimit të organit administrativ apo gjyqësor,tridhjetë **(30) €** për çdo pronar.

Neni 31

Tarifa për regjistrimin e bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët

1. Tarifa për regjistrimin e të drejtës në bashkëpronësi apo pronësi të përbashkët për bashkëpronarin apo pronarin e përbashkët,tridhjetë **(30) €**.
2. Tarifa për regjistrimin e të drejtës në pronësi të përbashkët për bashkëshortët,tridhjetë **(30) €** për një titull juridik.
3. Tarifa për regjistrimin e njësisë kadastrale si pjesë e ndërtesës,njëzet e pesë **(25) €** për njësi.
4. Tarifa për regjistrimin e njësisë kadastrale të krijuar nga ndarja apo bashkiminjëzet **(20) €** për njësi.
5. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e pronësisë së përbashkët të ndërtesave kolektive në bashkëpronësi.
6. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta si njësi të veçanta.

Neni 32

Tarifa e regjistrimit të ndarjes së bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët

1. Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndarjes nga bashkëpronësia apo pronësia e përbashkët për secilin bashkëpronar që bëhet pronarë individual,tridhjetë **(30) €**.
2. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e ndarjes nga bashkëpronësia sipas nenit 6 parag.3 dhe 4 i Udhëzimit Administrativ Nr.12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës.

Neni 33

Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare

1. Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë, dhjetë **(10) €**.
2. Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë, e cila rrjedh nga testamenti,njëzet **(20) €**.
3. Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar,njëzet **(20) €**.

Neni 34

Tarifat e regjistrimit të pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme

Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndërrimit-këmbimit të pronës së paluajtshme për secilin pronar,katërdhjetë **(40) €**.

Neni 35

Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtja

1. Tarifa për regjistrimin të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje deri në 10 vite,.....dhjetë **(10) €**.
2. Tarifa për regjistrimin të drejtës së shfrytëzimit- qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej dhjetë (10) vite deri në katërdhjetë (40) vite,tridhjetë **(30) €**.
3. Tarifa për regjistrimin të drejtës së shfrytëzimit- qirambajtjes për çdo njësikadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej katërdhjetë (40) vite deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vitepesëdhjetë **(50) €**.
4. Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje deri në dhjetë (10)vite për çdo njësi kadastrale,.....dhjetë **(10) €**.
5. Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje mbi dhjetë (10) vite për çdo njësi kadastrale,.....njëzet **(20) €**.
6. Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit- qirambajtjes, për pronat e privatizuara nga ish Ndërmarrjes Shoqërore, me kohëzgjatje prej nëntëdhjetë e nëntë vite (99), bëhet duke zbatuar tarifën e përcaktuar sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje.

Neni 36

Tarifat për regjistrimin e Hipotekës

1. Tarifa për regjistrimin e hipotekës sipas vlerës së kredisë të përcaktuar me dokumentin e hipotekës janë:
 - 1.1 deri në tridhjetëmijë (30.000) €,..... njëzet **(20) €**;
 - 1.2 prej tridhjetëmijë e një (30.001) € deri në pesëdhjetëmijë (50.000)€,tridhjetë **(30) €**
 - 1.3 prej pesëdhjetëmijë e një (50.001) € deri në njëqindmijë (100.000) €,gjashtëdhjetë **(60) €**;
 - 1.4 prej njëqindmijë e një (100.001) € deri në dyqind mijë (200.000) €, nëntëdhjetë **(90) €**;
 - 1.5 prej dyqind mijë e një (200.001) € deri në pesëqind mijë (500.000) €,njëqind e njëzet **(120) €**;
 - 1.6 prej pesëqind mijë e një (500.001) € deri në një milion (1.000.000) €.....dyqind e katër dhjetë **(240) €**;
 - 1.7 mbi vlerën e njëmilion (1.000.000) €, tarifkatërqind **(400) €**.
2. Hipoteka e cila regjistrohet në dy apo më shumë ZKK, tarifa përpjestohet në mënyrë të barabartë.

Neni 37

Tarifat për modifikimin dhe fshirjen e hipotekës

1. Tarifa për modifikimin e hipotekës së regjistruar,.....dhjetë **(10) €**.
2. Tarifat e përcaktuara sipas Nenit 36të kësaj Rregulloreje, zbatohen në rastet e ndryshimit të vlerës së kredisë.
3. Lirohet nga tarifa fshirja e hipotekës nga Regjistri.

Neni 38

Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e servitutit

1. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së servitutit për secilën parcelë dominante apo person,tridhjetë **(30) €.**
2. Tarifa për modifikimin e servitutit,dhjetë **(10) €.**
3. Tarifa për fshirjen e servitutit nga Regjistri,.....njëzet **(20) €.**

Neni 39

Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e barrave dhe ngarkesave tjera

1. Lirohet nga tarifa regjistrimi i barrës.
2. Lirohet nga tarifa regjistrimi i masës së sigurisë (masës së përkohshme) apo modifikimin e saj.
3. Tarifa për regjistrimin e vërejtjes sipas Ligjit për Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshmekatër dhjetë **(40) €.**
4. Tarifa për regjistrimin e ndalesës nga Përmbaruesi Privat apo Gjykata në procedurë përmbarimore për çdo akt juridik,tridhjetë **(30) €.**
5. Tarifa për regjistrimin e vërejtjes të mbajtësit në pronën e paluajtshme të të mbajturit në momentin e lidhjes së Kontratës mbi mbajtjen e përjetshme,.....njëzet **(20) €.**
6. Lirohet nga tarifa modifikimi i barrës apo ngarkesës tjetër.
7. Lirohet nga tarifa fshirja e barrës apo ngarkesës tjetër.

Neni 40

Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale

1. Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasojë e dokumentacionit të dorëzuar nga palët,.....tridhjetë **(30) €.**
2. Lirohet nga tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar si pasojë e gabimit të ZKK apo AKK, si dhe të gjitha gabimet e konstatuara nga sistemet e mëparshme
3. Lirohet nga tarifa për korrigjimin e numrit identifikues “KCID” në numrin personal tëpronarëve. ZKK është e obliguar që të bëjë korrigjimin e numrit identifikues “KCID” sipas detyrës zyrtare.

Neni 41

Tarifa për shërbimet online

1. Tarifa për nxjerrjen e certifikatave online tre **(3) €.**
2. Obligohen përdoruesit e institucioneve publike dhe përdoruesit privat të cilët ofrojnëshërbime publike që të bëjnë shënimin në Regjistrin kadastral, për pronën e paluajtshme qëështë në procedurë ose është përfunduar. Shënimi ne Regjistër bëhet pa pagesë.

Neni 42

Tarifa për regjistrimin e të drejtave tjera

Tarifa për regjistrimin e të drejtave të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat e kësaj Rregullorejepesëdhjetë**(50) €.**

Neni 43

Pajisja me certifikatë

ZKK apo AKK janë të obliguar që pas çdo ndryshimi në Regjistër të e pajisë palën me certifikatë pronësie dhe kopje pa pagesë.

Neni 44

Tarifat për dhënien e informatave nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës nga ZKK-të

1. Tarifat për dhënien e informatave nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës nga ZKK-të janë:

- 1.1. Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona,tri (3€).
- 1.2. Dhënia e vërtetimeve të ndryshme,tri(3€).
- 1.3. Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura),katër (4€).
- 1.4. Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura),njëzet (20€).
- 1.5. Kopja e planit, katër(4€).
- 1.6. Kopje në formatin A3 me ortofoto(bardhë e zi),katër (4€).
- 1.7. Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor), pesë (5€).
- 1.8. Historiati për një njësi kadastrale,.....njëzet (20€).

Neni 45

Tarifat për bazën gjeodezike

1. Tarifat për bazën gjeodezike janë:

- 1.1. Pikat trigonometrike: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim.....pesë(5€).
- 1.2. Pikat lidhëse: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim.....katër(4€).
- 1.3. Pikat poligonale: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim..... tri(3€).
- 1.4. Pikë e nivelimit: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim pesë(5€).
- 1.5. Pikat në linjë: Koordinatat Y, X, H..... dy(2€).
- 1.6. Pikat e detajit Y, X,.....një(1€).

Neni 46

Tarifat për të dhënat në formën digjitale

1. Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) deri në 1 ha-sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) - dhjetë(10€) për njësi.
2. Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 1ha deri 2 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) -njëzet (20€).
3. Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 2.01ha deri 5 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) -katërdhjetë (40€).
4. Parcela në format digjital (shpfile,dëg, gml, ili) mbi 5 ha- (sipas kërkesës së palës, pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)gjashtë dhjetë (60 €).
5. CD—kompakt diskuzero euro e pesëdhjetë cent (0.50 €).

Neni 47

Tarifat e shërbimit për ndërrimin e kulturave të parcelave

1. Përgatitja e raportit për ndërrimin e kulturës së një parcele pa matje gjeodezikedhjetë(10€).

Neni 48

Qiraja për shfrytëzimin e tokës Komunale dhe objekteve afariste dhe banesore

1. Komuna mbledh qiranë për shfrytëzimin e pronës komunale nga personat fizik dhe juridik.
2. Vlera e qirasë për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale është vlera e tregut e cila bazohet në:
 - 2.1. Madhësinë e ndërtesës ose tokës së matur për metër katror ose ndonjë matje tjetër e sipërfaqes,
 - 2.2. Vendndodhjen dhe llojin e ndërtesës ose tokës dhe
 - 2.3. Qëllimin e shfrytëzimit, qoftë për ushtrimin e aktiviteteve afariste, tregtisë, banimit, bujqësisë ose punëve profesionale.
3. Komuna mund të përcaktojë një vlerë të qirasë e cila është më e ulët se e tregut nëse shfrytëzimi i propozuar i pronës komunale në mënyrë të qartë i shërben një qëllimi dhe interesi shoqëror ose publik i cili është përcaktuar si i këtillë sipas një rregullore të miratuar nga kuvendi komunal.
4. Caktimi i vlerës së tregut duhet të bëhet nga komisioni profesional varësisht nga objekti apo prona tjetër. Dhënia me qira e këtyre objekteve dhe paluajtshmërive bëhet vetëm pasi të përfillen të gjitha procedurat sipas ligjislacionit në fuqi.
5. Qiratë nga objektet afariste dhe banesore si dhe tokës:
 - 5.1. Për lokalet afariste të zonës së parë qiraja mujore për m² tarifa fillestare të jet.
..... 5.00€/m²
 - 5.2. Ndërsa për objektet e banimit po në të njëjtën zonë qiraja mujore të jetë.....1.00€/m²
 - 5.3. Për lokalet afariste të zonës së dytë qiraja mujore për m² të jetë.....3.00€/m²
 - 5.4. Ndërsa për objektet e banimit po në të njëjtën zonë qiraja mujore të jetë.....0.70€/m²
 - 5.5. Për lokalet afariste të zonës së tretë qiraja mujore për m² të jetë1.50€/m²
 - 5.6. Ndërsa për objektet e banimit po në të njëjtën zonë qiraja mujore të jetë.....0.40€/m²
 - 5.7. Qiraja e tokës zona e I (parë) dhe e II (dytë), vjetore për m² të jetë0.50€/m²
 - 5.8. Qiraja e tokës zona e III (tretë) dhe e IV (katërt), vjetore për m² të jetë.....0.30€/m²
 - 5.9. Qiraja e tokës zona e V (pestë) e deri të e VIII (teta), vjetore për m² të jetë.....0.20€/m²
 - 5.10. Qiraja për regjistrimin e kablllove nëntokësor-.....-0.15€/m²
6. Qiraja vjetore nga dhënia e tokës bujqësore në shfrytëzim sipas klasëve :
 - 6.1.Klasa I (parë) dhe II (dytë).....80€/ha
 - 6.2.Klasa III (tretë) dhe IV (katërt).....60€/ha
 - 6.3.Klasa V (pestë) deri në të VIII (tetën).....40€/ha
7. Të dhënat për caktimin e zonës të cilës i takon objekti afarist, banesor dhe toka bujqësore, meren nga Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Drejtoria e shërbime Pronëso- juridike dhe Kadastrit.

KAPITULLI XI
Neni 49
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI, SPORT DHE MERGATË

1. Tarifat e përgjithshme në kulturë, rinisë dhe sportit;

Nr.	<i>EMËRTIMI (i tarifës dhe taksave në shërbime)</i>	Vendi	<i>Euro</i>
1.1	Për çdo manifestim fitimprurës për palën të kontraktuar në shtëpinë e kulturës dhe objektet kulturore për 1, (një) orë	Shtëpia e kulturës	10€
1.2	Shfrytëzimi i sistemit të zërimit për çdo manifestim fitimprurës për palën për 1, (një) orë	Shtëpia e kulturës	2.00€
1.3	Shfrytëzimi i sistemit të zërimit për çdo manifestim fitimprurës për palën për 1, (një) orë – jashtë objektit	Shtëpisë së kulturës	5.00€
1.4	Anëtarësia vjetore për leximin e librave	Biblioteka	1.00€
1.5	Shfrytëzimi i terreneve sportive nga klubet sportive jashtë komunës për zhvillimin e ndeshjeve zyrtare	Palestra sportive	150.00€
1.6	Shfrytëzimi i terreneve sportive nga klubet sportive jashtë komunës për stërvitje për 1, (një) orë	Palestra sportive	10.00€
1.7	Shfrytëzimi i terreneve sportive nga klubet sportive private për zhvillimin e ndeshjeve sportive për 1, (një) orë	Palestra sportive	5.00€
1.8	Stërvitja e ekipeve sportive komunale për një sezonë 6 (gjashtë) mujore, Stërvitja nuk mund të zgjat më shumë se, 6 (gjashtë) orë stërvitje në javë	Palestra sportive	50.00€
1.9	Për ngjarje komerciale fitimprurëse për palën, fushata politike, për 1, (një) orë	Palestra sportive	20.00€
1.10	Për ngjarje kulturore dhe artistike fitimprurëse për palën, për 1, (një) orë	Palestra sportive	20.00€
1.11	Shfrytëzimi i terreneve rekreative-sportive nga klubet sportive private kur organizimi është fitimprurës për 1, (një) orë	Ambient të hapur	5.00€
1.11	Shfrytëzimi i terreneve rekreative-sportive dhe objektet përcjellëse nga klubet sportive private të Komunës tonë dhe qytetaret	Ambient të hapur	Falës

Neni 50

Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese Lirimi nga taksat)

1. Tubimet përkujtimore
2. Tubimet e organizuara nga KK Suharekë
3. Të gjitha aktivitetet e organizuara nga DKRSM
4. Të gjitha aktivitetet e organizuara nga institucioni parashkollor, shkollat fillore dhe shkolla e mesme publike
5. Shoqatat për persona me aftësi të kufizuara
6. Shoqatat e dalura nga lufta, familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës
7. Bashkësit fetare
8. Ngjarjet kulturore dhe artistike jo fitimprurëse për palën
9. Zhvillimi i ndeshjeve sportive ku nikoqir janë ekipet vendore

KAPITULLI XII

Neni 51

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, SIGURI DHE EMERGJENC

1. Tarifa (taksa) në shërbimet publike, siguri dhe emergjencë

Nr. R	<i>EMËRTIMI (i tarifës dhe taksave në shërbime)</i>	<i>Euro</i>
-------	---	-------------

1.1	Inspektimi me kërkesë të palës jashtë qytetit	10.00€
1.2	Inspektimi me kërkesë të palës në qytet	5.00€
1.3	Lëshimi i vërtetimeve, certifikatave dhe dokumenteve tjera	2.50€
1.4	Dhënia e pëlqimit për pompa të benzinës, pishina .etj.	15.00€
1.5	Shfrytëzimi i hapsirave publike rreth vend punishteve	1.00€/m²

KAPITULLI XIII GJOBAT KOMUNALE PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE DHE DOKUMENTEVE ZYRTARE

Neni 52

Gjobat lidhur me mos paraqitjen e lindjes dhe vdekjes

1. Çdo preson fizik përgjegjës i cili nuk paraqet lindjen e fëmijës në territorin e Komunës në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga data e lindjes kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerënjëzet euro (20 €).
2. Çdo person fizik përgjegjës i cili nuk e lajmëron vdekjen e personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e vdekjes së personit brenda Republikës së Kosovës, apo brenda gjashtë (60) ditëve për vdekjet e ndodhura jashtë Republikës së Kosovës, kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerëpesëdhjetë euro (50€).
3. Çdo drejtues i spitalit, burgu, institucionit të riedukimit dhe institucioneve tjera përkatëse, i cili nuk e lajmëron vdekjen e personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda (5) ditëve nga data e vdekjes së ndodhur në institucionet e tyre, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë.....njëqind euro (100€), ndërsa pesëdhjetë (50€)do të dënohet zyrtari kompetent.

Neni 53

Gjobat lidhur me vendbanimin dhe vendqëndrimin

- 1.Me gjobë prej (50€) pesëdhjetë do të dënohet për kundërvajtje qytetari që nuk e lajmëron ndërrimin në afatin prej 8 (tetë) ditësh nga dita e vendosjes tek organi kompetent i vendbanimit të ri:
 - 1.1. nuk e lajmëron vendbanimin dhe ndërrimin e adresës së banimit apo nuk ç'lajmëron vendbanimin e përhershëm;

KAPITULLI XIV GJOBAT KOMUNALE PËR SHËRBIMET PUBLIKE

Neni 54

Gjobat për mos pagesën e taksës komunale për Linjat Urbane dhe Autotaxi

1. Operatori i transportit të udhëtarëve (për automjetet 8+1 ulëse e më shumë) që operon pa licencë, leje apo rend të udhëtimit dënohet me gjobë prej njëmijë (1,000.00€) euro, ndërsa personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë prejnjëqind (100.00€)
- 2.Çdo person fizik dhe juridik që ushtron veprimtarinë taxi, shërbime pa leje pune dënohet me gjobë.....prej njëqind (100.00€)
3. Skadimi i lejes së operimit për auto taxi më tepër se dhjetë ditë, dënohet me gjobë prej.....dhjetë (10.00€)

Neni 55

Gjobat për mos pagesën e taksës komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale-gropimi i sipërfaqeve publike

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale pa leje të organit kompetent komunal, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

- 1.1. për personin fizik.....njëqind euro (100 €)
- 1.2. për personi fizik që ushtron biznes individual..... dyqind euro (200 €) dhe
- 1.3. për personin juridik.....treqind euro (300 €)

Neni 56

Gjobat lidhur me taksat komunale për vendosjen e objekteve në hapësirat publike

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirën publike sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, e cila kalon vlerën mbi njëqindë euro (100 €), kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

- 1.1. Individët dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual–pesëdhjetë euro (50€) dhe
- 1.2. Shoqëritë tregtare tjera.....njëqind euro (100€)

Neni 57

Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës komunale për vendosjen e panove reklamuese

1. Çdo shoqëri tregtare i cili nuk paguan taksë komunale mbi vendosjen e panove reklamuese në hapësirën publike gjobitet.....njëqindë euro (100€)

Neni 58

Gjobat për mos pagesë taksës komunale për bllokimin e rrugëve lokale

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për bllokimin e rrugëve lokale sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

- 1.1. Personat fizik dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual tridhjetë euro(30€)
- 1.2. Personat juridiknjëqind euro (100€)

Neni 59

Gjopa për ushtrimin e veprimtarisë afariste pa pëlqim për plotësimin e kushteve

1.Çdo subjekt afarist që ushtron veprimtarinë afariste pa Pëlqim nga inspektorati i tregut për pranim të kushteve teknike për ushtrimin e veprimtarisë gjobitet me gjobë dhe atë:

- 1.1. Personat juridiknjëmijë (1000€)
- 1.2. Personi përgjegjës i personit juridik.....treqind (300€)
- 1.3. Personat fizikdyqind (200€)

Neni 60

Pagesat e gjobave dhe çështjet tjera mandatore

1. Gjobat të përcaktuara me këtë Rregullore paguhen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga datat e shqiptimit të tyre.

2. Në rast të pagimit të gjobës së shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit tetë (8) ditësh, pagesa bëhet pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar.
3. Shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse me gjobë dhe e drejta në mjete juridike të personave ndaj të cilëve shqiptohet gjobë bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës për kundërvajtjet dhe legjislacionin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.
4. Procedurat kundërvajtëse zhvillohen nga Komuna në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 61

Taksa Qendrore

1. Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komuna ofron shërbime të ndryshme të deleguar nga niveli qendror dhe mbledhë taksë të përcaktuar nga ky nivel, si në vijim:
2. Taksa sipas Udhëzimit Administrativ (MMPH) NR.12/19, i datës 15.11.2019 Për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës, Udhëzimi Administrativ (MEA) NR. 09/2020 i datës 12.11.2020 Për Tarifat e Shërbimeve Për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme si dhe me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.05/2021i datës 08.12.2021 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimi Administrativ (MEA) Nr.09/2020 Për Tarifat e Shërbimeve Për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme;
3. Taksa për dhënien e lejes mjedisore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH -Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Komunale Mjedisore, apo çdo legjislacioni pasues;
4. Taksa për shërbimet shëndetësore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2007 – Mbledhja dhe Shfrytëzimi i Mjeteve nga Bashkë Pagesat e Shfrytëzuesve të Shërbimeve Shëndetësore dhe të Hyrave Vetanake të Institucioneve Shëndetësore si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.04/2013 për certifikatat shëndetësore apo çdo legjislacioni pasues;
5. Taksa për vijim dhe përfundim të arsimit dhe aftësimin për të rritur të përcaktuara sipas Rregullores (MASHT) Nr. 01/2017 për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional dhe arsimit për të rritur, apo çdo legjislacion pasues;
6. Taksa për lëshimin e dokumentacion arsimor dublikate, të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013–Lëshimi i Dokumenteve Dublikatë nga Institucionet Edukativo – Arsimore dhe Universitare, apo çdo legjislacion pasues;
7. Çdo akt normativ tjetër i Qeverisë së Republikës së Kosovës apo ndonjë agjencie të pavarur që miratohet pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje që parasheh taksa qendrore, zbatohet nga Komuna, pa pasur nevojë që kjo Rregullore të ndryshojë.
8. Udhëzimadministrativ nr. 06/2010 për mënyrën dhe procedurat e shitjes se trungjeve pyjore dhe asortimenteve drusore nga pyjet publike.

Neni 62

Transparenca në taksat komunale

Kuvendi Komunal përditëson taksat dhe gjobate kësaj Rregulloreje me një vendim dhe të publikon ato, kurdo që Qeveria e Republikës së Kosovës apo ndonjë agjenci e pavarur ndryshon taksat ekzistuese qendrore apo përcakton ndonjë taksë tjetër.

KAPITULLI XV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 63

Epërsia me Ligjet dhe aktet tjera nënligjore

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj rregullore dhe në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi e të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 64

Zbatimi

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 65

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet, Rregullorja 01-Nr-16-12102 të datës 01/12/2015, për tarifa, ngarkesa dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale.

Neni 66

Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

Neni 67

Implementimi

Kjo rregullore fillon të zbatohet-implementohet nga **01 janari i vitit 2024**

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____

Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI